



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec



Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec
REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNES/SKUPSTINA OPSTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY

RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/221, Nr. i faq./Br.str./No.pg 65

Data/Datum/Date 29.04.2024

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 pika r) dhe s) dhe nenin 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 8, paragrafi 2 dhe nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-245 për Artin dhe Kulturën ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 4/2024"), nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57, paragrafi 1, pika 1.18 dhe 1.19, të Statutit të Komunës, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës në Rahovec, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.04.2024, miraton këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës, me Nr. Prot. 02/4044/24, i datës 04.04.2024 dhe merret vendimi për themelimin e Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe.
2. Muzeu i Masakrës së Krushës së Madhe do të jetë institucion kulturor lokal, i cili do të bëjë arkivimin, selektimin, ruajtjen dhe promovimin e dokumenteve dhe të gjëseneve të tjera të trashëgimisë së luajtshme me peshë historike individuale dhe shoqërore të Masakrës në Krushë të Madhe, të datës 26 mars 1999.
3. Qëllimi i themelimit të Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe është: mbledhja, sistemimi, ruajtja dhe ekspozimi i artefakteve, dokumenteve e gjëseneve të të vrarëve dhe të të zhdukurve me dhunë nga forcat shtetërore serbe në Krushë të Madhe. Muzeu ka për qëllim dokumentimin e krimeve serbe në marsin e vitit 1999, respektivisht paraqitjen e fushatës së vrasjeve, djegieve, shkatërrimeve e spastrimit etnik të kësaj zone, të kryera në datat: 25-26-27 mars 1999, si dhe paraqitja reale e krimeve të bëra nga forcat serbe, duke përfshirë vendet e ekzekutimeve në grupe të njerëzve, djegien e kufomave (krematoriumet), si dhe prezantimin e dhunës sistematike serbe ndaj banorëve të kësaj ane. Muzeu ka vlerë kulturore e historike dhe është i ndarë në kënde ku do të ekspozohen dëshmi e artefakte të ndryshme, që pasqyrojnë fragmente të jetës së personave të vrarë, të grave, të fëmijëve, të mësuesve e të njerëzve të paarmatosur, këndin e dëshmorëve dhe dëshmi materiale e shpirtërore të atyre që u zhdukën me dhunë në Krushë të Madhe.
4. Muzeu, në funksion të realizimit me sukses të veprimtarisë, të detyrave dhe të kompetencave të tij, do të organizojë njësitë përkatëse organizative me punonjës të kualifikuar, të cilët do të përgatisin statutin dhe aktet e tjera normative, të cilat do të dërgohen për miratim në Kuvendin e Komunës.
5. Selia e Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe, do të jetë në fshatin Krushë e Madhe-Komuna e Rahovecit, respektivisht në Parcelën Kadastrale Nr. P-71513005-00465-0.

6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Kryetari të Komunës,**
- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,**
- **Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr.221/24
Datë:29.04.2024



Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit